



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË



Data 17/07/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje automjeti kamion borëpastrues”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Makina pastruese bore 43313100-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

***7,798,889 (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë)
lekë pa tvsh.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Korçë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës të përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor **jo më vonë se data 31 mars** e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës të perlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës të perlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", si dhe Udhëzimin e ministries së transportit dhe infrastruktures me nr.1546, datë 29.03.2016. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i caktuar me udhërin e Nr. 778 datë 02.07.2026 sipas procesverbalit të mbajtur prej tij.

Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mjetit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për këtë mjet i cili do të ndihmojë Ndërrmarjen e Sherbimeve Publike Bashkia Korçë në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në respektim të nenit 36 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Konkretisht:

1. APV – Automjet për përdorim të veçantë

Argumentim: Përdorimi specifik i mjetit për përballimin e situatave dimërore dhe për pastrimin e rrugëve nga bora e kërkon një mjet të përshtatur për qëllime të posaçme. Përcaktimi lidhet me funksionalitetin dhe nuk kufizon konkurrencën pasi kategorizimi "APV" është i gjerë dhe përfshin automjete nga shumë prodhues të ndryshëm.

2. 4x4 (të katër rrotat aktive)

Argumentim: Rrjetet rrugore që shërben Ndërrmarja e Sherbimeve Publike përfshijnë edhe zona të vështira malore dhe me akses të kufizuar. Sistemi 4x4 është funksionalisht i domosdoshëm për t'i siguruar automjetit aftësi të rritura të lëvizshmërisë dhe qëndrueshmërie në kushte dimri.

3. Vetësharkues me vinç.

Argumentim: Karrocëria vetëshkarkuese mundëson transportin dhe shkarkimin e shpejtë të materialeve antirrëshqitëse, si kripa, rëra, çakëlli ose përzierje të tjera abrazive, pa nevojën e pajisjeve shtesë për ngarkim-shkarkim. Kjo rrit efikasitetin operacional gjatë situatave emergjente dhe redukton kohën e reagimit në segmentet rrugore të prekura nga kushtet atmosferike.

4. Vinçi të jetë i vendosur prapa kabinës.

5. Të dhënat e vinçit:

- Në distance 2.5 metra të ngrejë 4000 kg.
- Në distance 4.5 metra të ngrejë 2400 kg.
- Në distancë 7.5 metra të ngrejë 1300 kg.

Argumentim: Vendosija e vinçit prapa kabinës siguron shpërndarje më të mirë të ngarkesës mbi shasinë e mjetit, rrit stabilitetin gjatë operacioneve të ngritjes dhe lejon shfrytëzimin maksimal të hapësirës së karrocerisë vetëshkarkuese. Ky konfigurim është një zgjidhje e përdorur gjerësisht në automjetet shumëfunksionale të mirëmbajtjes rrugore, pasi garanton siguri më të lartë gjatë punës dhe mundëson kryerjen e operacioneve të ngarkim-shkarkimit pa penguar fushën e shikimit të drejtuesit të mjetit.

Kapaciteti minimal prej 4000 kg në rreze pune 2.5 metra është i nevojshëm për ngritjen dhe transportimin e pajisjeve të rënda, përfshirë agregate shpërndarëse të kripës, pajisje borepastrimi, elemente të infrastrukturës rrugore dhe materiale të tjera që përdoren gjatë ndërhyrjeve emergjente.

Kapaciteti minimal prej 2400 kg në rreze 4.5 metra garanton mundësinë e operimit në kushte ku mjeti nuk mund të pozicionohet pranë objektit që duhet ngritur, duke mundësuar vendosjen ose largimin e pajisjeve dhe materialeve në mënyrë të sigurt nga skaji i karrexhatës ose nga zona me akses të kufizuar.

Kapaciteti minimal prej 1300 kg në rreze 7.5 metra siguron aftësinë për të kryer ndërhyrje në distancë më të madhe nga pozicioni i mjetit, veçanërisht në raste të largimit të pengesave nga rruga, vendosjes së elementeve të sinjalistikës, ngarkimit të materialeve apo manipulimit të pajisjeve në zona ku pozicionimi i drejtpërdrejtë i automjetit është i pamundur për arsye sigurie ose konfigurimi të terrenit.

3. Pesha e mjetit $\geq 5T$

Argumentim: Pesha lidhet drejtpërdrejt me stabilitetin e mjetit gjatë operimit me pajisjet për pastrim bore dhe shpërndarje kripe. Mjetet më të lehta nuk garantojnë qëndrueshmëri dhe janë të rrezikshme për manovrim në rrugë të rrëshqitshme.

4. Fuqia motorike ≥ 100 kW dhe cilindrata ≥ 3000 cc

Argumentim: Mjeti do të përballojë ngarkesa të konsiderueshme (borë dhe kripë), si dhe terrene të vështira. Këto parametra janë minimumi teknik i nevojshëm për të siguruar fuqi të mjaftueshme për funksionimin efikas.

5. Viti i prodhimit jo më i vogël se 2012

Argumentim: Mjetet e prodhuara pas vitit 2012 përmbushin standarde të përmirësuara teknike dhe të sigurisë (Euro 5 e lart), dhe kanë jetëgjatësi të mbetur më të lartë. Përcaktimi synon të

shmangë blerjen e mjeteve të amortizuara, duke garantuar efektivitet ekonomik dhe siguri në operim. Kjo lidhet me standardet e teknologjisë dhe ruan proporcionalitetin me objektin dhe vlerën e kontratës

6. Lëndë djegëse: Naftë

Argumentim: Nafta është karburanti më efikas dhe ekonomik për mjete të rënda dhe për përdorim intensiv në kushte të vështira. Ky përcaktim është standard për kategori të tilla mjeteve.

7. Transmision manual me rridoto

Argumentim: Në kushtet e terreneve të pjerrëta ose rrëshqitëse, transmetimi manual me rridoto mundëson kontroll të shtuar të çiftit motorik dhe të fuqisë së shpërndarë në rrotat aktive.

8. Me thike perpara me sistem hidraulik ne te katert pozicionet (lart,posht,majtas,djathtas) me komandim nga kabina e drejtuesit te mjetit.

Argumentim: Lëvizja hidraulike në drejtimet lart-poshtë mundëson përshtatjen e thikës me profilin e rrugës, shmangien e dëmtimit të sipërfaqes rrugore dhe kapërcimin e pengesave të vogla gjatë operimit. Kjo veçori është e nevojshme për të garantuar efikasitetin e pastrimit në segmente rrugore me konfigurime të ndryshme gjeometrike.

Mundësia e orientimit majtas dhe djathtas lejon drejtimin e borës jashtë karrexhatës sipas kushteve konkrete të terrenit dhe organizimit të qarkullimit, duke rritur efektivitetin e pastrimit dhe duke shmangur rikthimin e borës në korsinë e lëvizjes.

Komandimi i të gjitha funksioneve nga kabina e drejtuesit siguron operim të vazhdueshëm dhe të sigurt, pa qenë e nevojshme që operatori të ndalojë mjetin ose të dalë nga kabina për rregullime manuale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë kushteve atmosferike të vështira, në temperatura të ulëta, në prani të reshjeve intensive ose në rrugë me qarkullim aktiv.

Përdorimi i sistemit hidraulik garanton reagim të shpejtë, kontroll të saktë të pozicionit të thikës dhe rritje të produktivitetit gjatë operacioneve të borepastrimit. Për pasojë, kjo kërkesë përbën një karakteristikë thelbësore funksionale për realizimin e objektivit të kontratës, që është mbajtja e rrugëve të kalueshme dhe garantimi i sigurisë së qarkullimit gjatë sezonit dimëror.

9. Me gjerësi te thikes jo më pak se 2 m dhe jo ë shume 4.5 m dhe lartesi 0.8m

Argumentim: Kërkesa që thika borepastruese të ketë gjerësi jo më pak se 2 metra dhe jo më shumë se 4.5 metra, si dhe lartësi minimale 0.8 metra, është e lidhur me nevojën për të siguruar efikasitetin e operacioneve të borepastrimit dhe përshtatshmërinë e mjetit me karakteristikat e rrjetit rrugor që administrohet nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i një gjerësie minimale prej 2 metrash garanton që mjeti të ketë kapacitet të mjaftueshëm pune për pastrimin efektiv të karrexhatës dhe të reduktojë numrin e kalimeve të

nevojshme për pastrimin e një segmenti rrugor. Një thikë me gjerësi më të vogël do të ulte produktivitetin dhe do të rriste kohën e ndërhyrjes gjatë situatave me reshje intensive bore.

Nga ana tjetër, kufiri maksimal prej 4.5 metrash synon të sigurojë manovrueshmërinë e mjetit në rrugë me gjerësi të ndryshme, në kthesa, ura, zona urbane dhe segmente me kufizime fizike, duke shmangur përmasat e tepërta që mund të krijojnë vështirësi operationale ose rreziqe për sigurinë e qarkullimit.

Lartësia minimale prej 0.8 metrash është e nevojshme për të garantuar kapacitet të mjaftueshëm për grumbullimin dhe largimin e masave të konsiderueshme të borës nga sipërfaqja rrugore. Një lartësi më e vogël mund të kufizonte efektivitetin e pastrimit, veçanërisht në raste të reshjeve të dendura ose të krijimit të grumbujve anësorë të borës.

8. Depozitë kripe me shpërndarës centrifugal

Argumentim: Depozita dhe mekanizmi i shpërndarjes janë pjesë integrale e funksionalitetit dimëror të mjetit.

9. Kapaciteti i depozitës $\geq 2 \text{ m}^3$

Argumentim: Ky kapacitet siguron mbulim të mjaftueshëm të rrugëve pa ndërprerje për furnizim, duke rritur efikasitetin dhe ulur kostot operative.

10. Standardi i ndotjes: Euro 4

Argumentim: Në përputhje me detyrimet mjedisore dhe me politikat kombëtare për mjetet publike, siguron emetime më të ulëta dhe konsum më të mirë.

11. Kondicioner, goma të reja, garanci ≥ 12 muaj

Argumentim: Këto specifikime sigurojnë kushte pune të sigurta dhe të përshtatshme për stafin, si dhe ruajnë integritetin teknik të mjetit pas blerjes. Garancia mbështet cilësinë dhe angazhimin e OE për produktin e tij.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT